

Për: Z. Pandeli Majko  
Ministër i Shtetit për Diasporën  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1.1000  
Tiranë, Republika e Shqipërisë

Prishtinë, Republika e Kosovës  
2 korrik 2018

**Bashkëbisedim virtual me Ministrin e Shtetit për Diasporën z.Pandeli Majko  
KËSHILLI KOORDINUES PËR DIASPORËN  
ÇMIMI AMBASADORI I KOMBIT**

Vendimet e miratuara së fundmi nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë lidhur me zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës dhe mbi kriteret e mënyrën e ndarjes së çmimit "Ambasador i Kombit", ishin arsyet e organizimit të një bashkëbisedimi virtual (26.06.2018) në mes të Diasporës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majkon.

Germin, si ndërmjetësues i këtij takimi, ftoi 15 pjesëtarë nga komunitet e Diasporës, të cilët vinin nga 10 shtete të ndryshme të Botës si: ShBA, Kanada, Turqi, Gjermani, Zvicër, Greqi, Itali, Britani e Madhe, Francë dhe Spanjë.

Përballë një paneli divers nga diaspora, Ministri Majko u përgjigj dhe dha sqarime për pyetjet dhe kërkesat që pjesëtarët patën për këto dy tema, por edhe për të tjera si vota e diasporës, rrjeti i bizneseve në Diasporë, angazhimi i Diasporës në diplomaci & lobim dhe për Samitin e Diasporës 2.0.

**Paneli diskutues përbëhej nga:**

1. Mark Kosmo, drejtues i shoqatës MAAS Besa dhe anëtar i bordit të Germin, Boston, ShBA;
2. Arben Merkoçi, profesor dhe drejtues i Nanobioelectronics dhe Biosensors Grup në Institutin *Català de Nanociencia i Nanotecnologia*, Spanjë;
3. Brikena Muharremi, avokate, drejtuese e Shoqatës së Avokatëve Shqiptaro-Britanik (BALA ) dhe anëtare e bordit të Germin, Mbretëria e Bashkuar;
4. Ilir Zenku, ekspert për sistemet informatike në shëndetësi, shoqata USKANA, Çikago, ShBA;
5. Artan Ajazaj, specialist i investimeve në Bankën Botërore, Uashington D.C., ShBA;
6. Viola Kaloutsi, eksperte për migrim, Kanada;
7. Lulzim Sylja, partner menaxher në kompaninë Elen Group dhe anëtarë i bordit këshillues të Germin, Gjermani;
8. Albana Sejati, shoqata e shqiptarëve "VATRA Stamboll", Turqi;
9. Avni Dervishi, politolog dhe ish-deputet, Suedi;
10. Selam Hajrizi, lobues dhe lider në Task Forcën e Germin për Filantropinë, Francë;
11. Osman Osmani, bashkë-themelues i platformës Prointegra.ch, Zvicër;
12. Mimoza Leka, mësuese e gjuhës shqipe, Gjermani;
13. Nestor Dede, anëtar i Task Forcës së Germin *E drejta e votës dhe Përfaqësimi i Diasporës në Kuvend*, Greqi;
14. Skender Perpepa, biznesmen, Mbretëria e Bashkuar;
15. Emidio Tedeschini, avokat, Itali.

Diskutimi u moderua nga Liza Gashi, Drejtoreshë e Programeve në Germin, Kosovë.

Më poshtë, ju lutemi gjeni të bashkangjitur rekomandimet dhe komentet në lidhje me vendimin nr.339 i datës 6.6.2018 dhe vendimin nr.340 i datës 6.6.2018, të dala nga diskutimi virtual dhe nga kërkesat e adresuara nga pjesëtarët e Diasporës përmes e-mail tek GERMIN.

## **Këshilli Koordinues i Diasporës**

### ***Një Këshill Koordinues i përbashkët për Diasporën Shqiptare:***

1. Të krijohen mundësitë dhe mekanizmat për një Këshill pan-shqiptar global për Diasporën shqiptare, i përbërë nga të gjitha shtete ku ka shqiptarë (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit);
2. Për të siguruar bashkëpunim më të mirë në të ardhmen, ne propozojmë që të themelohet një Grup Punues i përbërë nga: anëtarë të Diasporës, përfaqësues nga ana e Ministrive të Diasporës në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Ky grup do të punojë në çështjet që kanë të bëjnë me Këshillin e Diasporës dhe çështjet e tjera të Diasporës me tema të detajuar që do të zhvillohen gjatë muajve të ardhshëm. Po ashtu, ky grup do të mund të vëzhgojë procesin e përzgjedhjes për anëtarët e Këshillit, ndihmojë në organizimin e Samitit të Diasporës dhe të ofrojë sugjerime në lidhje me politikën dhe programet që duhet zhvilluar në lidhje me angazhimin e Diasporës.

### ***Rekrutimi i anëtarëve të Këshillit:***

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe vendeve tjera duhet të ketë konsensus me pjesëtarët e komuniteteve të Diasporës gjatë procesit të rekrutimit për anëtarët e Këshillit. Prandaj, ne propozojmë që të përgatitet një Memorandumi Mirëkuptimi mes Ministrive në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe organizatës Germin, se si të ecim përpara në këtë çështje në mënyrë sa më bashkëpunuese, dhe të dëshmohet nga ana e Qeverisë që procesi i rekrutimit të anëtarëve të Këshillit do të jetë i panashëm, transparent dhe jo i ndikuar nga politikën ditore;
2. Të mos zgjidhen përfaqësuesit/kryetarët e degëve të partive politike që janë në Diasporë;
3. Përveç misionëve diplomatike, këtë rast Ambasadave, të krijohet një mekanizëm tjetër për mbledhjen e jetë përshkrimeve/aplikacioneve të personave që duan të jenë anëtar të këtij Këshilli. Kësisoj, kjo do të ishte garanci për disa arsye si: dëshmon paanshmëri në zgjedhjen e anëtarëve; proces jo i ndikuar nga politika; incentivë për personat e tjerë të aplikojnë ngase një numër i madh i bashkatdhetarëve nuk kanë marrëdhënie të mirë dhe besim tek Ambasadat në vendin ku jetojnë;
4. Të ofrohet mundësia që edhe Diaspora të votojë online/apo të gjendet një mënyrë që ky Këshill të marrë aprovimin dhe legjitimitetin nga komuniteti i Diasporës, të cilët do të përfaqësojnë interesat e tyre në Këshill;
5. Të diskutohet dhe të ofrohet propozimi për largimin e anëtarëve nga ky Këshill. Kështu që, duhet të hartohet dhe publikohet një kod i etikës dhe një rregullore, sidomos në rastet e konfliktit të interesit;

### ***Obligimet, detyrimet, angazhimet dhe strukturimi i Këshillit:***

1. Të parashikohet dhe të planifikohet buxhet dhe financa për të ofruar qëndrueshmëri për këtë mekanizëm, dhe të shikohet mundësi që anëtarët e këtij Këshilli të paguhet.

- Në këtë drejtim, Ministria dhe grupet e tjera të interesit duhet të kërkojnë fonde edhe nga donatorët ndërkombëtar;
2. Të definohet roli konkret i anëtarëve të këtij Këshilli, i cili mund të jetë për të ndihmuar Qeverinë në bërjen e politikave për Diasporën; apo të ndihmojë në organizimin shtetëror dhe administrativ të organizatës shtetërore nga përvoja e tyre profesionale;
  3. Në Shtator të vitit 2018 të publikohen udhëzimet dhe Plani i Veprimit për veprimtarinë e Këshillit. Kësisoj, gjatë Samitit të Diasporës, kjo duhet të jetë njëra ndër pikat e diskutimit. Ne rekomandojmë që ky Këshill duhet të fillojë punën gjatë vitit 2019.
  4. Të rritet numri i përfaqësuesve të këtij Këshilli që vijnë nga Europa, duke marrë për bazë numrin e madh të shqiptarëve në Itali, Greqi, Gjermani, Zvicër, Austri etj;
  5. Të qartësohet saktë koha, angazhimi, detyrat dhe detyrimet e anëtarëve të Këshillit;
  6. Të sigurohet pavarësi e plotë dhe transparencë gjatë diskutimeve brenda këtij Këshilli përmes kanaleve të ndryshme të transmetimit qoftë virtuale, mediave tradicionale etj;
  7. Të rritet numri i takimeve për anëtarët e Këshillit - jo vetëm 1 herë brenda vitit, në mënyrë që të pjesëmarrja të jetë aktive dhe e frytshme. Të ofrohen mundësi të tjera për takime - sikurse diskutimet virtuale që organizon Germin;
  8. Të definohet qartë roli i secilit koordinator nga shteti që do të përfaqësohet - A do të jetë roli i tij të strukturoj/organizoj diasporën ku jeton; të mbledh rekomandime dhe kërkesa nga grupet formale dhe joformale atje; apo të mbajë takime të rregullta me administratën shtetërore;
  9. Të njoftohet dhe të promovohet më shumë se pse këto 2 vendime janë të rëndësishme për shqiptarët jashtë vendit;
  10. Të respektohet barazia gjinore për përfaqësim - 7 prej anëtarëve të jenë gra;
  11. Të publikohen dhe të definohen detyrimet e funksionarëve shtetëror ndaj këtij Këshilli;
  12. Anëtarët e Këshillit të pajisen me etiketa/dokument zyrtar të lëshuar nga Qeveria. Një anëtar i këtij Këshilli që përfaqëson Diasporën e shtetit ku është duhet të definohet qartësisht dhe të ketë qasje në hapësirat e ambasadave dhe konsullatave, si dhe në infrastrukturën e disponueshme;
  13. Të definohet përmes rregullores marrëdhënia e anëtarëve të Këshillit me shtetin ku ata gjenden në mënyrë e përfaqësimit, bashkëpunimit institucional, etj.

### **Çmimi "Ambasadori i Kombit"**

1. Të shikohet mundësia për ndryshimin e emrin "Ambasadori i Kombit" ngase shumica e shqiptarëve jashtë vendit janë ambasadorët jo zyrtarë të Shtetit Amë. Një emërtim mund të jetë: Shqiptarët e Pavdekshëm; Ambasador/e i/e Mërgatës; Ambasador/e i/e Diasporës; Ambasador/e i/e Shqiptarëve nëpër Botë. Po ashtu, të jetë edhe emërtimi "Ambasadore e Kombit", përshkak të dy gjinive.
2. Ambasador/e i/e Kombit të shpallen edhe jo-shqiptarët, të cilët me punën dhe kontributin e tyre kanë nderuar kombin shqiptarë;
3. Të ndryshohet pika B e vendimit 339 duke u strukturuar kështu: *Kontribut i veçantë për kombin shqiptar apo diasporën;*
4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk duhet të përfshihet në propozimet për këtë çmim. Skenar të ngjashëm mund të kemi si ai me çmimin "Shqiponja e Artë". Për këtë, duhet të krijohet edhe një mekanizëm/platformë që Diaspora dhe të tjerët të rekomandojnë përfaqësuesit më të suksesshëm jashtë vendit;
5. Të zhvillohet një platformë online për personat që janë dekoruar me këtë çmim, duke promovuar gjuhën e tyre në disa gjuhë të Botës;
6. Për çmimin "Ambasadori i Kombit" të ketë koordinim me Ministrinë e Diasporës në Kosovë, Maqedoni dhe institucionet nga Mali i Zi, Lugina e Preshevës, Medevgjës dhe Bujanovcit;

7. Të promovohet më shumë rëndësia e këtij çmimi dhe të qartësohet më mirë se këtë çmim mund ta pranojnë edhe bashkatdhetarë nga Kosova, Mali i Zi, Serbia apo Maqedonia.

### **Samiti i Diasporës 2.0**

1. Të publikohen më herët datat për organizimin e Samitin e Diasporës 2.0 dhe rezultatet e Samitit të parë;
2. Të përfshihen në mënyrë formale për organizimin e Samitit të Diasporës grupe të caktuara si: organizata nga shoqëria civile si p.sh Germin dhe organizata të tjera nga Diaspora, pjesëtarë nga Diaspora, komuniteti ndërkombëtarë, me qëllim që programi të jetë i bazuar në kërkesat dhe nevojat për shqiptarët jashtë vendit;
3. Të krijohet një grup punues 10-15 persona, i cili do të udhëheq planifikimin organizativ. Në këtë grup punues të përfshihen edhe përfaqësues nga Ministria e Diasporës në Kosovë, Maqedoni dhe përfaqësues nga Mali i Zi, Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit. Data tentativ për të filluar punën grupi punues: 01.08.2018;
4. Të formohet një strategji e përbashkët e Diasporës Shqiptare, që do të jetë themeli për Samitin e Diasporës në vijim *(pika 2 nga Këshilli Koordinues)*.

### **Të tjera**

1. Të rritet numri i stafit në misionet Diplomatike të cilat do t'i ndihmojnë Shtetit Amë, respektivisht Ministrit për Diasporën në organizimet dhe strukturat me komunitet jashtë vendit;
2. Të dërgohen atash/oficier/koordinator për Diasporën në misionet diplomatike;
3. Ministri i Shtetit për Diasporën të koordinohet me Ministrinë e Diasporës në Kosovë për funksionalizimin e Rrjeteve të Bizneseve në Diasporë;
4. Të jepen nënshtetësi për shqiptarët jashtë vendit;
5. Të futet në Strategji të Ministrisë dhe Qeverisë roli i Diasporës për Integrimet Europaine, Diplomaci dhe Lobim;
6. Të kërkohet nga MSDH që Ambasadat e Shqipërisë të kenë një komunikim më të rregullt duke krijuar marrëdhënie bashkëpunimi. Këta vakume duhet të përfshihen me Strategjinë e re;
7. Në reformën zgjedhore dhe Ligjin për Diasporën të përfshihet edhe mundësia për votim jashtë vendit, sikurse e ofron Kosova apo Maqedonia.

Shpresojmë që pikat e përmendura më lartë do ofrojnë një qasje të re të bashkëveprimit dhe një dialog të dyanshëm në mes të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe shqiptarëve jashtë vendit. Është detyrë e jona që t'ju informojmë dhe t'ju ndihmojmë për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Sinqerisht,  
Liza Gashi, Drejtoreshë e Programeve në Germin  
[www.diasporaflet.org](http://www.diasporaflet.org)

